



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 414/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 12.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET poshtë ankesa si e palejuar e subjektit politik, Aleanca Kosova e Re (AKR).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 10.12.2010, nga subjekti politik AKR, me te cilën pretendohet se KQZ-ja ka mbuluar posterat e subjektit politik AKR, me posterat e tyre, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur 2 (dy) fotografi si dëshmi. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

KODI I MIRËSJELLJES PËR SUBJEKTET POLITIKE, MBËSHTETËSIT E TYRE DHE KANDIDATËT

Neni 32 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

Këtij kodi i detyrohen të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se shkeljet e pretenduara në ankesë janë të palejuara nga shkakut se “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët” i detyrohen të gjitha subjektet politike ndërsa institucioni i ankimuar në rastin konkret nuk është subjekt politik. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë, në pajtim me dispozitat e cituara ligjore dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

A nr. 414/2010 më datën 12.12.2010.

